## cilët janë lezbiget dhe gay?

Jo të gjitha lezbiket dhe jo të gjithë gay përjetojnë homoseksualitetin e tyre qetësisht dhe pa u fshehur: frika nga dënimi që mund t'i japë shoqëria, nga mohimi familjar, nga humbja e punës, nga diskriminimi, nga fajshmëria që u jepet nga autoritetet fetare shtyjnë shumë lezbike dhe gay t ë mos bëjnë të njohur dhe t'i fshehin nganjëherë edhe vetvetes prirjen e vet seksuale.

Ndërsa ata që nuk e fshehin të qenit lezbike apo gay rezikojnë izolimin dhe diskriminimin: shumë lezbike pësojnë shtypje nga ana e familjes dhe shumë gay janë goditur dhunshëm.

Konfliktet më të mëdha në lidhje me prirjen seksuale dalin n ë pah gjatë adoleshencës dhe, në se nuk kuptohen dhe mb ështen nga ambienti shoqëror dhe familjar i vajzës apo djalit, mund të çojnë në veprime vetëshkatërrimtare. Sa më të rrepta të jenë modelet femërore dhe mashkullore që paraqiten, aq më e vështirë është të përjetohet qetë identiteti personal.

Falenderojmë

Komisjonin Evropjan
Provincia Firenze
Bashkia Firenze
Bashkia Campi Bisenzio
Bashkia Fiesole
Bashkia Lastra Signa
ARCI N.A. Provincia Firenze
Azienda Sanitaria Locale n.10 Firenze
SETA Helsinki
Gay Hiv Strategies Dublino
Gay Switchboard Dublino

që kanë bërë të mundur këtë nismë

## do të mjaftonte të mendojmë...

Të mendojmë që prapa disa malinkolive dhe trishtimeve fshihet frika e të qenit lesbike ose gay.

Të mendojmë që çdo batutë e jona antihomoseksuale mund të lëndojë një lezbike ose gay që mund të jetë prezent.

Të mendojmë që njera nga miket tona më të mira mund të jet ë lezbike, që njeri nga miqtë tanë më të mirë mund të jetë gay, dhe që nuk e kanë shprehur kurrë nga frika se mund të humbin miqësinë tonë.

Të mendojmë se sa siklet mund të shkaktojnë pyetje si "e ke të dashurën" për një gay dhe "e ke të dashurin" për një lezbike, "kur do të martohesh" për të dy.

Të mendojmë që për t'i shpëtuar isolimit dhe frikës do të mjaftonte pak:të gjesh shoqen apo shokun të cilit mund t'i hapësh zemrën, të njohësh lezbike të tjera apo gay të tjerë n ëpërmjet telefonave miq (telefoni amici), shoqatave, grupeve të të rinjve …

Në Firence egziston AZIONE GAY E LESBICA (Veprimtaria Gay dhe Lezbike) e cila është një shoqatë e njohur së cilës mund t'i drejtohesh për të takuar gay dhe lezbike të tjera, për të shkëmbyer opinione dhe për t'u zënë miq.


**Azione Gay e Lesbica**
Onlus Arci N. A. Finisterrae

via Pisana, 32 R, FIRENZE - Tel. 055 220250
e-mail: info@azionegayelesbica.it
http.//www.azionegayelesbica.it



Firenze 2006 – materiali i shtypur brenda projektit "Të dë rmosh paragjykimet, të parandalosh dhunën" bashkë financuar nga Bashkia Firence-Drejtoria e Sigurisë Sociale

Kjo fletëpalosje është realizuar në vitin 1998 në kuadrin e Iniciativës DAPHNE me kontributin ekonomik të Komisjonit Evropjan


komisjonin evropjan
iniciativës daphne

# kush është

ajo **vajza**

ai **djali**

**te njohësh për të mos diskriminuar**




**Azione gay e lesbica**
Onlus Arci N. A. Finisterrae
Firenze 2006

# kush është ajo vajza ai djali

… si fillim, në këtë depliant do të flasim për shumë gjëra por sidomos për gay dhe lesbike që do të thotë burra që dashurojnë dhe dëshirojnë seksualisht burra të tjerë si dhe gra që dashurojnë dhe dëshirojnë seksualisht gra të tjera.
Gay dhe lezbike kanë egzistuar gjithnjë, në çdo vend dhe në çdo kulturë: Ajo që u mohon egzistencën dhe të drejtat duke i kthyer në të padukshëm janë pikërisht konvencionet sociale.
Në disa vende gay dhe lezbiket janë të persekutuar dhe të dënuar për shkak të orientimit të tyre seksual dhe jan ë të detyruar të fshehin natyrën e tyre të vërtetë. Në vende të tjera gay dhe lezbike kanë të drejta të barabarta me të gjithë të tjerët: për shembull dy lezbike dhe dy gay mund të martohen, mund të kenë ose të adoptojnë fëmijë.
Në shumë vende të botës, në të gjithë kontinentet, egzistojnë lëvizje politike të organizuara nga gay dhe lezbike që luftojnë me sukses për të fituar më shumë liri, më shumë respekt dhe më shumë të drejta.
Shumë të huaj me banim në Itali vijnë nga vende ku për fat të keq gay dhe lezbike diskriminohen. Në Itali situata nuk është përpar si në disa vende në veri të Evropës apo në Spanjë, por liria dhe respekti janë të garantuara dhe personat gay dhe lezbike janë gjithnë e më të dukshëm.

Por nga ana tjetër paragjykimet ndaj homoseksualitetit kanë rrënjë të vjetra. Mungesa e informacionit, qoftë kundrejt diversitetit seksual qoftë kundrejt seksualitetit n ë përgjithësi, akoma krijon dëme, sidomos në moshë adoleshenciale. Në fakt shumë vajza dhe shumë djem zbulojnë homoseksualitetin e tyre qysh në fillim të adoleshencës. Mbetet e vështirë për të gjithë (prindër, m ësues, mjekë) të sillen me vajzat dhe djemtë që zbulojn ë se janë lezbike apo gay, sidomos për faktin se mungon një informacioni i saktë.
Ky deplian bën pjesë në një projekt kundër dhunës fizike dhe psikologjike për të miturit lezbike dhe gay, mbë shtetur nga Komisioni Evropjan në kuadrin e iniciativës Daphne realizuar në vitin 1998.
Nga kërkimet e kryera në Itali gjatë projektit, ka rezultuar, ashtu siç pritej, një dhunë që egziston: ndë rmjet atyre që janë përgjigjur, 40% pohojnë se kanë pë suar diskriminim, 30% pohojnë se kanë pësuar dhunë (sidomos nga grupi i shoqëve apo nga familjarët)40% pohojnë se kanë menduar të vetëvriten dhe 13% kanë tentuar vërtet të vetëvriten.
Nuk duhet të gënjehemi nga reklamat dhe nga programet e televizionit italian në modë. Lezbiket nuk janë vetëm sportive të suksesshme apo shkrimtare, gay nuk janë vetëm stilistë apo aktorë të famshëm; shumica e personave lezbike dhe gay janë njerëz normalë, vazhdojnë të përjetojnë ose kanë mbi shpatulla një adoleshencë jashtëzakonisht të vështirë.
Qëllimi i kësaj fletëpalosje është t'u japim të gjithë personave të interesuar disa informacione të thjeshta bazë, që vështirë mund të gjenden jashtë lëvizjeve të nd ërmarra nga gay dhe lezbike.

# le të shpjegojmë më mirë se si thuhet në italisht

## HOMOSEKSUALITET - LESBIKE DHE GAY

Është me orientim homoseksual ai (grua apo burrë) që dashurohet dhe dëshiron të ketë marrëdhënie seksuale me persona të të njejtin seks. Fjala italiane "lesbica" (fjal ë që në shqip thuhet lezbiKe) përdoret për një grua që t ërhiqet nga gra të tjera. Fjala italiane "gay" (fjalë që në shqip thuhet "gay" përdoret për një burrë që tërhiqet nga burra të tjerë.
Lezbiket dhe gay identifikohen sipas seksit biologjik; lezbiget janë gra dhe e ndjejnë veten gra; gay janë burra dhe e ndjejnë veten si të tillë.

## ETEROSEKSUALITETI

Është me orientim eteroseksual ai (grua apo burrë) që dashurohet dhe dëshiron të ketë marrëdhënie seksuale me persona të seksit të ndryshëm nga seksi i tij. Grua eteroseksuale është ajo grua që tërhiqet nga burrat, burr ë eteroseksual është ai burrë që tërhiqet nga gratë.
Personat eteroseksualë, meqenëse përbëjnë pjesën më të madhe të personave shpesh konsiderohen pa arsye persona normalë.

## BISEKSUALITETI

Janë biseksualë ata burra apo gra që tërhiqen edhe nga burrat edhe nga gratë – qoftë me periudha qoftë në më nyrë të vazhdueshme.

## TRANSEKSUALIZMI DHE TRANSGJINIA

Transeksual është ai që, edhe pse është lindur biologjikisht burrë apo grua, ndjen se i përket seksit të kundërt. Në Itali ligji 164/82, parashikon, tani për tani, mundësinë e ndryshimit të seksit mbas një proçedure q ë përfundon me ndërhyrje kirurgjikale. Vetëm më tej mund të ndryshohet emri në gjendjen civile (në italisht anagrafe). Transeksualiteti ka të bëjë me gra që e ndjejn ë veten burra ose me burra që e ndjejnë veten gra.
Transgjini është ai që në vetvete nuk i përket eksluzivisht vetëm gjinisë mashkullore dhe as vetëm gjinisë femërore, duke refuzuar në këtë mënyrë kundë rvenien e detyruar "burrë-grua"

## TRAVESTITIZMI

Flitet për travestitizëm kur një burrë vishet dhe trukohet si grua dhe kur një grua vishet si burrë. Nuk egziston nj ë lidhje midis travestitizmit, transeksualitetit, transgjinisë dhe orientimit seksual.

# disa informacione

Organizzata Botërore e shëndetsisë në vitin 1993 e ka hequr homoseksualitetin nga lista e sëmundjeve; aktualisht homoseksualiteti konsiderohet një lloj i mundshëm i sjelljes seksuale.Të jesh gay dhe lezbike ë shtë një karakteristikë personale dhe në se nuk je i tillë, nuk mud të bëhesh i tillë kur njeh, frekuenton, bën miqë si me gay dhe lezbike.

Sipas të dhënava të marra nga vetë Organizzata Botë rore e Shëndetsisë ata që janë lezbike dhe gay përbëjn ë 5-10 % të popullsisë botërore ( do me thënë edhe të vendit tënd) – në Itali për shembull janë nga 3 deri në 6 miljon.

Prirja homoseksuale, siç e kemi thënë tashmë, është p ërhapur njëlloj në të gjitha kulturat, në të gjitha klasat shoqërore, në periudha të ndryshme të historisë dhe nj ëlloj si në mes të grave dhe ashtu edhe në mes të burrave.

Lezbiket dhe gay përjetojnë seksualitetin dhe dashurinë në të njejtën mënyrë si edhe gratë dhe burrat e tjerë.